VENDIM
Nr.841, datë 17.12.2004

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT ME KONCESION, TË FORMËS "BOT", TË AUTOSTRADËS RROGOZHINË-TIRANË (PEZË)-RINAS-THUMANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 2 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime dhe në infrastrukturë", të ndryshura, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës "BOT", të autostradës Rrogozhinë-Tiranë (Pezë)-Rinas-Thumanë, sipas projektit të paraqitur nga shoqëria "STRABAG, A=WAY INFRASTRUKTUR PROJEKTENTWIK LUNG-UND-BERT IEBS, GMBH", si propozim i pakërkuar.

2. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit të jetë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), për të negociuar dhe nënshkruar marrëveshjen e koncesionit.

3. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano